



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

#### **EKSTRAKT**

**nga Procesverbali i mbajtur më 25 shtator 2018, në mbledhjen e VI-të (gjashtë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.35’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Floretë Zejnullahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS,

#### **Rendi i ditës**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** e hapi mbledhje, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth rendit të ditës, shtoi, nëse ndokush prej anëtarëve dëshiron të marr fjalën urdhëroni, nëse jo e hedh në votim sipas materialit të dërguar.

*Njëzëri nga anëtarët prezent (8 anëtar sa ishin për momentin) u miratua rendi i propozuar i ditës.*

#### **1. Propozimi i vendimit për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore 2020-2021**

**z.Isuf Latifi,** drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me propozim vendimin për vitin 2019 dhe projeksionet për vitin 2020-2021. Ministria e Financave ka lëshuar Qarkoren Buxhetore 2019/02 me të cilën janë përcaktuar kufijtë final për vitin 2019 dhe projeksionet për vitin 2020-2021, dhe në bazë të saj është bërë edhe shpërndarja e buxhetit nëpër kategoritë përkatëse e që nëse bëjmë një krahasim me buxhetin e propozuar sipas kësaj qarkoreje dhe kornizës afatmesme buxhetore shihet që është pothuajse i njëjtë, me një rritje simbolike 2 euro më shumë. Megjithatë ka ndryshime në kategori ekonomike ku me qarkoren buxhetore 2019/01, sepse në fakt kur është përgatit Korniza Afatmesme e Shpenzimeve kemi qenë të lirë në planifikime në kategori ekonomike

varësisht prej kërkesave dhe nevojave të Komunës, mirëpo në Qarkoren Buxhetore 2019/02 edhe kjo liri e vogël është cunuar sepse Ministria e Financave ka përcaktuar të gjithë kufijtë nëpër kategoritë ekonomike përkatëse duke filluar nga paga dhe medijtje, mallra dhe shërbime, subvencione dhe shpenzime kapitale. Ndryshimet janë në paga ku ka një rritje të theksuar për mësimdhënësit konkretisht për të realizuar kontratën kolektive në arsim dhe tri paga me rastin e pensionimit, pastaj ka ndryshime te kategoria mallra dhe shërbime ku është rrit kjo kategori për 220,000.00 €, ka ndryshime te kategoria e komunalive përkatësisht është një ngritje prej 75,000.00 €, mandej te kategoria e kapitaleve ka zvogëlim të buxhetit për rreth 340,000.00 €, si dhe kemi zvogëlim të buxhetit në kategorinë e subvencioneve rreth 23,000.00 €. Pra, nëse krahasohet ky propozim buxhet me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve janë këto ndryshime, ajo që dëshiroj të them se rreth 95% e buxhetit të propozuar është i ngjashëm me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për shkak se këto shpenzime kanë ndikuar që edhe një pjesë e vogël të pësoj ndryshime, sidomos tek investimet kapitalet ku ajo shumë afër 340,000.00 €, është dashtë të zvogëlohet ose eventualisht të bëhet ndonjë ndryshim i vogël te projektet kapitale dhe këto ndryshime janë të theksuara posaçërisht në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit si dhe zvogëlim i ndjeshëm tek Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në kategorinë e subvencioneve kemi zvogëlim për rreth 23,000.00 € për arsye se aty është një shumë më e madhe e mjeteve të koncentruara dhe nuk kemi mund ti zvogëlojmë shpenzimet sikurse që nuk kemi mund të veprojmë as për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të kësaj pike të rendit të ditës ku sigurisht kemi për të diskutuar për çështjet që janë me interes për buxhetin.

**znj.Adelinë Stublla**, edhe ne Grupi i LVV-së i rekomandojmë për Kuvendi për shqyrtim.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sa i përket propozim buxhetit të Komunës, ndër të tjera, duke parë nevojën për intervenim në rrugën e fshatit Bellopojë si një rrugë pothuajse e pakalueshme do të doja që të parashihet në planifikime buxhetore në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Sigurisht e keni parë atë rrugë se nuk ka vendosje të shtyllave dhe aty rrëshqet vazhdimisht dheu. Tani në kuadër të planifikimeve buxhetore nuk e kam vërejtur se është përfshirë ajo rrugë por jam në dijeni se buxheti mund të lëviz në të ardhmen me rishikim mirëpo e pashë të arsyeshme të cekë këtë sepse ka ankesa të shumta për atë rrugë e që sigurisht u janë paraqitur edhe juve si Ekzekutiv. Duke pasë parasysh që është edhe Burgu i Sigurisë së Lartë, mendoj që ndoshta do të ishte mirë të bashkëpunohet edhe me Ministrinë e Drejtësisë sa i përket bashkëfinancimit të asaj rruge në mënyrë që të gjenden alternativa dhe zgjidhet ai problem sepse në atë rrugë ka lëvizje dhe qarkullim të madh. Pra vetëm e ceka si rast që ndoshta në të ardhmen mund të shikohet se çfarë mund të bëjmë edhe pse e di që ajo rrugë ka një kosto por urgjente është pjesa te shkolla. Sa jam në dijeni në mandatin e kaluar ka qenë i paraparë një buxhet rreth 60,000.00 € nga Ministria e Drejtësisë për rregullim të asaj rruge deri tek qendra korrektuese por tani nuk besoj që është ruajtur ai buxhet. Andaj vetëm desha të paraqes si problem nëse ka buxhet dhe mund të bëhet dhe nëse mund të hyj si prioritet në 3 vitet e ardhshme, përndryshe edhe Grupi i këshilltarëve të PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, besoj që z.Faik Muçiqi i cili në kuadër të Drejtorisë ka edhe sektorin e emergjencave, do ta ketë parasysh çështjen e ngritur nga parafolësi. Nëse nuk ka ndokush diçka për të shtuar, e hedh në votim.

*Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore 2020-2021.*

## 2. Shqyrtimi i Peticionit të banorëve të disa fshatrave lidhur me ndërtimet e hidrocentraleve në territorin e Komunës së Podujevës

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** theksoi, rreth kësaj pike do të ishte mirë të ishte prezent z.Hamdi Jaha drejtor i DPUMM, i cili nuk është prezent sot. Mendoj se është mirë që peticionin ta dërgojmë në Kuvend ku edhe mund të debatojmë më gjerësisht rreth shqetësimeve të qytetarëve sidomos kur kanë të bëjnë me situata të interesit më të madh. Andaj edhe besoj që ne duhet ta debatojmë dhe shqyrtojmë në mënyrë që ne të jemi në nivelin që duhet të jemi dhe shqetësimet e qytetarëve t'i shohim.

**z.Avni Fetahu,** theksoi, mendoj se rreth kësaj çështje do të ishte mirë të na jap një opinion rreth kësaj çështje Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit z.Durim Salihu i cili ishte Drejtor i DPUMM, dhe i cili është në rrjedha që nga fillimi i çështjes në fjalë dhe është në dijeni për shqetësimet e atyre banorëve.

**z.Fitim Haziri,** theksoi, peticioni është paraqitur më 23.08.2018, kurse ne tani jemi në muajin e shtator, andaj këto vonesa janë paksa shqetësuese, por megjithatë jemi për t'i rekomanduar Kuvendit për shqyrtim.

**z.Rafet Llapashtica,** theksoi, faktikisht peticionet duhet të shqyrtohen, unë e kam shikuar materialin që na është dërguar dhe mund të them se nuk ishte kronologjia e lidhjes së problemit. E vërteta është se Kuvendi i Komunës nuk lëshon leje të ndërtimit, por ne mund të diskutojmë rreth shqetësimeve të atyre banorëve. Vërejtja që disa banorë janë të atij vendi dhe disa nuk janë rezident, shumë pak pash prej banorëve rezident, në bazë të materialeve po shihet që ky fenomen mundet me qenë një vjetarë në bazë të asaj çka ata kishin shënuar, por tash nuk po di detaje tjera. Faktikisht kjo lidhet drejtpërdrejt me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit Urbanizmit – DPUMM. z.Durim Salihu tani është në një detyrë tjetër dhe nuk e di sa është në rrjedhën e kërkesës së investitorit dhe qysh kanë rrjedhë pëlqimet për arsye se lumenjtë janë pasuri nacionale dhe nën menaxhim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - MMPH, mandej a ka pasë investitori pëlqim prej Ministrisë dhe a është sjellë në Drejtorinë përkatës për pëlqim, për leje ndërtimi dhe plan urbanistik, jemi në dijeni që në zona të thella nuk kemi plan urbanistik si Komunë. Gjithashtu jemi në dijeni se nëse nuk menaxhohet ashtu si duhet nganjëherë hidrocentralet mund të paraqesin pengesa, mirëpo nëse ato në mënyrë kronologjike rrjedhin me të gjitha parametrat juridik, me pëlqimin e Ministrisë, debate me qytetar e që nuk kam dijeni a janë mbajta apo jo, janë gjëra të cilat ne duhet t'i diskutojmë me Drejtorinë përkatëse. Rreth pëlqimeve qofshin urbanistike apo leje që duhet të japë sipas planin urbanistik apo çfarëdo që duhet për tu ndërtuar një hidrocentral është mirë të jepet një përgjigje nga Drejtoria përkatës në mënyrë që ne pastaj të mund të diskutojmë më gjerë, pastaj duhet të dimë që edhe investitori apo kërkuesi i investimeve a i ka të kompletuara të gjitha ato dokumente që duhet ti ketë, sepse kjo është ajo që neve na intereson. Ne nganjëherë e themi se nuk guxojmë të dalim kundër investimeve, por gjithëherë edhe investimet duhet të bëhen në parametrat ku nuk e dëmtojnë ambientit dhe qytetarët që jetojnë në ato zona, në këtë kontekst ne po i shqyrtojmë këto peticione edhe pse nuk jemi aspak në rrjedha të problemit por, a ekziston lënda ndokund në Drejtori ne vetëm jemi në dijeni që ata njerëz janë ankua ma shumë nuk dimë. Unë do të shikoj se kush është investitori edhe pse kam informata se ai është nga fshati Kerpimeh ose Metehi, këtë e them në bazë të kompanisë sepse e di që ajo merret me elektronik dhe në bazë të të dhënave të përgjithshme që ekzistojnë e njeh këtë fushë. Nuk mund të them asgjë në këtë moment për arsye se ndoshta me këtë investim dikush punësohet në atë zonë. Mandej nuk e di nëse ky investim prek apo jo në pronën publike e që do të duhej të merrej vendim në Kuvend, nëse investimi bëhet në pronë private, a janë bërë të gjitha shpronësimet, gjë e cila del pastaj në një fushë tjetër. Pastaj po të marrim në aspektin juridik duhet të njoftohemi ne se ai investitor a i ka marr të gjitha pëlqimet prej KEDS-i për kycje në rrjetin e transmissioinit të lartë, si dhe dokumente tjera, nëse investitori i ka bërë të gjitha këto dokumentacione atëherë mbetet te Komuna të vendosë pozitivisht. Unë jam në dijeni që edhe një ligj tjetër thotë që nëse kërkesa e palës apo investitorit

për investimet dytësore ku hyjnë fabrikat, hidrocentralet, nuk kthehet përgjigje nga institucioni brenda 45 ditëve, investitor ka të drejtë të kryej punën e vetë edhe pëlqimi llogaritet si i miratuar, ashtu e parasheh ligji, dhe në këtë aspekt nëse ka kalua afati prej 45 ditëve prej kur investitori ka bërë kërkesë edhe nuk është kthyer përgjigje është shkelje e procedurës administrative. Pastaj nëse është bërë peticioni pas afatit prej 45 ditëve del qe prap nuk kemi çka të diskutojmë për këtë peticion, ne mund të diskutojmë por ligjërisht nuk kemi për çfarë sepse pastaj dalim në një fushë tjetër, kështu që në këtë kontekst unë si këshilltar i Kuvendit konsideroj se ne vendim nuk mund të marrim por vetëm mund të diskutojmë që qytetarët janë të shqetësuar, se ne nuk japim leje, vetëm nëse është pronë publike e japim në shfrytëzim e që nuk jam në dijeni se a kemi të bëjmë me pronë publike apo private sepse në dokument nuk janë të sqaruara këto. Mua më intereson që investitori a është drejtuar në Drejtorinë përkatëse dhe në cilën datë është drejtuar, a janë kthyer përgjigjet qoftë edhe negative se nuk do të thotë përgjigjet me qenë pozitive gjithherë, nëse nuk janë kthyer, në çfarë janë bazuar që nuk janë kthyer, nëse problemi ka qenë i më hershëm pse nuk është marrë në diskutim më herët dhe nëse ka aplikuar në Drejtorinë përkatëse a i ka të gjithë elementet për me ardhë në Komunë, siç janë pëlqimi i Ministrisë, planin e investimeve, ofrimet e shërbimeve apo çka do të përfitoj Komuna përveç prodhimit të rrymës që ai fiton. a ka bërë ndonjë premtim që Komuna e Podujevës përfiton në punësim ,në regjenerim të rrymës apo ndonjë investim të rrugës qoftë një rrugë deri të hidrocentrali, a e ka marrë pëlqimin prej KEDS-it për kyçe në transmisionin e lartë apo vetëm dëshiron të ndërtoj ato edhe me bo pengesë, dua të them se neve si Kuvend dhe si Komunë na duhen këto dokumente. T'ju them të drejtën përveç materialit që e kam shikuar nuk kam gjetur ndonjë element tjetër, kam dashtë ta thërras kompaninë për të diskutuar mirëpo sërish jam tërheq sepse kam dashur që detajet të na i jap Drejtoria përkatëse dike pasë parasysh që nuk kemi nevojë t'i dëgjojmë të tjerët kur kemi organet përkatëse komunale. Përndryshe si pikë e rendit të ditës edhe nëse vetëm tre qytetar ngrisin shqetësim ne si Kuvend duhet të diskutojmë dhe shikojmë çfarë shqetësimesh kanë ata. Ne i rekomandojmë Kuvendit për diskutim, mirëpo është mirë që Drejtoria përkatëse të sjellë gjithë dosjen sepse ne nuk e dimë a të dalim në mbrojtje të qytetarëve, apo të ndokujt tjetër. Unë sa kam njohuri edhe investitori e ka një listë të nënshkrimeve në favor të ndërtimit të hidrocentralit, dhe në këtë aspekt ku kemi të bëjmë me dy palë të pakënaqura ne fillimisht duhet t'i dëgjojmë ato, por jo të dalim me qëndrime, njeri ka të drejtë tjetri jo. Pra duhet ti shikojmë dokumentet se a janë të kompletuara, por ne nuk kemi materiale tjera, ne vetëm e dimë se disa qytetarë janë të pakënaqur dhe po t'i pyesim ata hidrocentralet nuk ndërtohen. Pastaj nuk jemi në dijeni me kërkesën e Komunës për investitorin, nëse ka një të tillë, shembull se çka do të ndërtohet, cilat janë përfitimet e Komunës, punësimet dhe gjëra të ngjashme me rëndësi, unë do t'ia shtroja shumë pyetje edhe pse nuk po e di kush është ai person. Problem tjetër është që edhe nëse ne jemi kundër ndërtimit të hidrocentraleve prapëseprapë ato po ndërtohen, madje edhe në zona të mbrojtura nacionale siç është Valbona ose vende tjera të ngjashme, e që nuk do të thotë që ato dy hidrocentrale e dëmtojnë shumë ambientin se nëse ka vlerësuar Ministria, pastaj Komuna, dhe ekspert të ndryshëm si dhe në qoftë se janë lëshuar dokumentet e kërkuara, ne vetëm mund të diskutojmë këtu. Mirëpo si kronologji e dokumentit ajo dosje duhet të kompletohet me dokumente që ne të themi pastaj e kemi shqyrtuar problemin sepse nuk e kemi as një dokument për shqyrtim megjithëse ne mundemi edhe si këshilltar deri nesër të shikojmë se kompania "Monten" a ka kërkuar pëlqim për objektet në fjalë, a janë lëshuar pëlqimet nga Ministria përkatëse si hapa i parë, dhe nëse i ka marrë të gjitha dokumentet dhe ka mbet që vetëm Komuna të lëshoj lejen atëherë ne duhet të shikojmë në mënyrë të drejt dhe transparente që dokumentet t'i lëshojmë në bazë të parametrave ligjore pa asnjë kusht, por me kontaktuar me investitorin rreth punësimeve, investimeve etj të cilat shkojnë në favor të qytetarëve të Komunës. pastaj të shikohet dhe analizohet edhe çështja e pronave në atë zonë se a parashihet të ndërtohen hidrocentralet në prona publike apo private si dhe çështja e shpronësimeve sepse sa jam në dijeni unë duhet të bëhen gropa nëntokësore dhe mbitokësore të cilat lidhen me rrjedhën e lumit si dhe

rreth trasesë së shtrirjes së gypave deri te gjeneratorët. Përfitimet e atyre banorëve përreth ndër përfitimet tjera që do të kenë nga ndërtimi i hidrocentraleve është edhe çështje e stabilitetit elektrik sepse sa jam në dijeni rryma nuk guxon të ndale për shkak të gjeneratorëve. Përndryshe z.Durim Salihu ka qenë drejtor Drejtorisë përkatëse dhe mund të na sqaroj më shumë rreth lëndës në fjalë edhe pse jemi në dijeni s me rastin e ndërrimit të drejtorëve dokumentacionit mbeten dhe duhet vazhduar me shqyrtimin e tyre, por meqë drejtori aktual nuk është prezent sot na duhen informata shtesë rreth këtij investimi.

**z.Durim Salihu**, drejtor i DI, theksoi, lidhur me këtë temë, sa kamë qenë drejtor i DPUMM, operatori në fjalë ka bërë kërkesë zyrtare me të cilën i është drejtuar Drejtorisë për marrjen e një pëlqimi për hulumtim dhe shqyrtim për ndërtimin e hidrocentraleve. Në harmoni me ligjin, dhe Udhëzimet Administrative dhe Rregulloret tjera ne kemi qenë të obliguar që investitori (operatori ekonomik) t'i kthejmë përgjigje, dhe përgjigja e Drejtorisë për atë kohë sa kamë qenë unë drejtor ka qenë dhënia e pëlqimit në parim, por edhe ai pëlqim që është marrë në parim shumë mirë është i përshkruar se çfarë ka pasë të drejtë të bëjë operatori në fjalë, pëlqim i cili nënkupton marrje ose posedim me leje ndërtimore. Kjo ka qenë një dokument i cili është dashtë t'i lëshohet si përgjigje operatorit ekonomik që komuna jonë pas miratimit të Planit Zhvillimor Komunal nuk ka pasë plan të detajuar për atë zonë rurale, që është dashtë të vazhdoj procedurat tutje nga niveli qendror të pajiset me të gjitha dokumentacionet me ligjet aktuale që janë në fuqi. Në ndërkohë pasi është lëshuar ai pëlqim, pas disa muajsh operatori ka përsërit kërkesën për parcelë tjetër, duke thënë se nuk po dëshiroj tani për parcelën e parë, sa kuptoj unë operatori pasi ka vërejtur se Komuna nuk ka të planifikuar diçka për atë parcelë, i njëjti ka shpreh gatishmërinë që nuk e dëshiron pëlqimin për atë parcelë por është bërë kërkesa për në vend tjetër, dhe sërish sipas të njëjtës kërkesë të përsëritu vetëm është përsërit numri i ngastrës. Sa i përket çështjes së pronave, sa jam në dijeni disa prona private janë blerë nga ana e investitorit, por ndërkohë kur ka vazhduar procedurën tutje në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe në institucione tjera relevante, tek ne janë ankuar banorët e asaj zone dhe bashkë me përfaqësues e tyre dhe kanë ardhë një grup i madh i tyre në zyre time, të revoltuar pse i kemi jep pëlqim pa i pyet ata. Konsideroj se hapi jonë ka qenë valid dhe ligjor, dhe atyre banorëve jua kemi sqaruar qartë si qëndron problemi, ata kanë marrë hapa të mëtutjeshëm dhe janë ankuar në instanca tjera deri tek avokati i popullit, në Ministrinë e Mjedisit dhe në ndërkohë ai operator ekonomik ka kërkuar nga ne si Drejtori që të pajiset me kushte ndërtimore për shkak se nuk ka Plan Urbanistik ajo zonë. Procedura është që së pari të pajiset me kushte ndërtimore pastaj me leje ndërtimore. Unë e kam njoftuar së pari gojarisht se kemi një hall me qytetar sepse kanë shpreh një shqetësim dhe për momentin na nuk mundemi tutje të veprojmë asgjë, kërkon zgjidhje në nivel qendror, edhe qytetarët janë të njoftuar nëse operatori në fjalë pajiset me dokumentacion me të cilin janë të autorizuar Ministritë dhe autoritetet tjera përkatëse, ne si komunë nuk kemi në dorë asgjë, nuk mund të stopojmë po edhe nëse deshëm sepse është e nivelit qendror por, jemi zotuar që përderisa ai operator nuk pajiset me dokumentacion përkatës, përderisa nuk zgjidhen këto mosmarrëveshje unë në asnjë formë nuk lejoj as nuk lëshoj as kushte ndërtimore as leje ndërtimore gjë e cila edhe nuk ka ndodh. Kemi pas kontakte të mjaftueshme për këtë çështje dhe banorët kanë qenë shumë të revoltuar, është thënë në takim që Ministria e Mjedisit është e obliguar t'i mbaj debatet me qytetar, kurse qytetarët kanë thënë që ai debat është mbajtur me një grup të njerëzve të caktuar prej operatorit, po flas me fjalë të qytetarëve dhe nuk kanë qenë as përfaqësuesi e fshatit as pjesa dërmuese e asaj zone kështu që ai ka qenë debat nëse nuk gaboj në Reçicë, dhe pjesë dërmuese e banorëve nënshkrues të peticionit sipas tyre nuk kanë qenë pjesëmarrës në debat, madje as të njoftuar me atë çështje, dhe si banorë kanë reaguar pas atij debati, ndërkohë operatori ekonomik e ka sjellë një listë me disa nënshkrime kinse e kanë të drejtën dhe pëlqimin prej qytetarëve.

**z.Rafet Llapashtica**, pyetje drejtorit, a e keni atë listë drejtor?

**z.Durim Salihu**, drejtor i DI, përgjigjet pyetjes se duhet të jetë ajo listë në Drejtori siç është edhe ankesa e paraqitura zyrtarisht, ku një qytetar është ankuar se nënshkrimi nuk është i imi, kurse ne i kemi tregu që nuk jemi kompetent për vlerësimin e validitetit të nënshkrimi, dhe gojarisht ai person ka thënë ju është drejtuar edhe policisë. Kështu që ne përveç atij pëlqimi në parim nuk kemi jap asgjë. Atë nuk kemi mund ta ndalim edhe po të kishim dashtë sepse është obligim ligjor të jepet pëlqimi për hulumtimin. Nëse plotësohen kriteret dhe standardet e kërkuara prej Ministrisë përkatëse, pajiset me dokumentacion përkatës, komuna mbetet në pozitë që nesër je i obliguar në bazë të dokumentacionit që ofrohet, të pajiset me kushte ndërtimore, i kryen kushtet ndërtimore, pajiset me leje ndërtimore, kjo është gjendja në pika të shkurtra. Pas datës 20.12.2017 kurë e kamë përfunduar mandatin, as nuk di as nuk mund të them asgjë. Por sa jam në dijeni ai operator, kushte ndërtimore nuk ka, leje ndërtimore nuk ka, por ka vetëm një pëlqim në parim sipas të cilit i është mundësuar të bëjë hulumtimin dhe shqyrtimin për ndërtimin e hidrocentralit. Madje në atë pëlqim është e cekur se, nuk nënkupton marrjen e lejes ndërtimore, këtë mund ta gjejmë në dosje. Mund t'ju njoftoj se ka qenë gjendje shumë e acaruar, jemi munduar t'i qetësojmë banorët duke ju thënë se duhet të gjejmë mirëkuptimin kur kemi të bëjmë me interes apo dëm. Qytetarët mbështeten në atë që ajo zonë rrezikohet sepse hyn sasi e madhe e ujit në gypa dhe do të mbetet shtrati i lumit pa ujë dhe nuk do të ketë ujë, kjo është arsyeja kryesore e qytetarëve të cilët çdo herë kanë trokitë në zyre të Drejtorisë e cila çdo herë ka pas presion, madje të paktën dy-tre herë në javë ajo masë më kanë ardhë në zyre tek unë. Në ndërkohë kur ka aplikuar operatori në fjalë, ka kërkuar kushtet ndërtimore, dhe ka ofruar dokumentacion e që nuk më kujtohet saktë çfarë ka pasë por, me sa e di nuk ka qenë i kompletuar, por që ne nuk i kemi kthyer përgjigje përveç asaj gojore që i kemi kërkuar të gjejnë mirëkuptimin e operatorit me qytetarë gjë që nuk ka ndodhë dhe ka mbet kështu si ka mbet.

**z.Rafet Llapashtica**, replikë drejtorit parafolës, theksoi, nëse nuk keni kthyer përgjigje brenda 45 ditëve pozitive apo negative, llogaritet pëlqim. Në parim të gjithë ne duhet ta mbrojt këtë pasuri dhe këtë kornizë të pronës publike dhe jetës së këtyre qytetarëve, për këtë jemi këtu. Ligji e parasheh që një operator nëse e ka marrë pëlqimin në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në KEDS për kyçje në transmision, e ka planin e vetë të detajuar për dy hidrocentrale, e ka mbajt një debat publik, e ka marrë pëlqimin paraprak për një hulumtim strategjik rreth vendosjes së gypave, e ka bërë një kërkesë ligjore tek ju që brenda 45 ditëve t'i ktheni përgjigje negative ose pozitive dhe që të dy përgjigjet lëshohen me arsyetim, mandej nëse operatori ka ndjek vazhden e kronologjisë hap pas hapi konform ligjit dhe procedurës administrative, i njëjti ka të drejtë të paditë institucionin në gjykatë kurdo që ai e parasheh të nevojshme, dhe në bazë të planit të funksionimit të hidrocentralit duhet të bëhet kompensimi i dëmit nga buxheti i Komunës varësisht kalkulimeve se kur është dashtë të funksionalizohet hidrocentrali. Kështu që mendoj se nuk mund të lirohet askush duke u mbështetur në atë se nuk i kemi kthyer përgjigje, por do të ishte mirë të kthehej përgjigja, çfarëdo qoftë ajo, sepse institucioni nuk mund të lë pezull një gjë të tillë, për askënd qofshin qytetarë qofshin investitorin, për këtë jemi institucion, jemi shtet dhe nuk guxojmë të mbahet ashtu për arsye të dikujt, por të kthehet ose negativ ose pozitiv. Sa kam vërejtur unë, arsyeja pse nuk është dhënë përgjigje, është neglizhenca politike po e quaj kështu. Ajo çfarë nuk kam informata është se nuk e di ai operator a është pajisur me gjithë dokumentacionin e rregullt në institucione tjera dhe në fund është bllokuar në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit ku drejtor ishte z.Durim Salihu, mirëpo afatet e kanë zënë drejtorin aktual z.Hamdi Jahën, po ashtu duhet të informohemi me lëndën se deri ku ka shkuar si proces, a janë kthyer përgjigjet ngase tani lejet edhe pëlqimet të MMPH-së janë afatgjate tre-katë vjeçare, operatori nuk aplikon më, por e merr lejen, i pret afatet kohore dhe deponon me padi, kurse ne duhet të ndajmë buxhet për kompensim, këtu është problemi. Unë qysh nesër para seancës së Kuvendit do të shkoj në MMPH dhe të mundohem të marrë informata rreth kësaj çështje përkatësisht rreth dokumentacionit që posedon operatori, pastaj rreth dokumentacionit të Departamentit të ujërave, dhe

ato të pasurisë nacionale, nëse operatori nuk i posedon këto dokumentacione dhe disa të institucioneve tjera, nuk ka çfarë të kërkoj në Komunë, si dhe shtroj pyetje, a posedon ai operator leje nga MMPH.

**z.Durim Salihu**, drejtor, i DI-së, përgjigje parafolësit, theksoi, nuk mund të them saktë sepse kjo periudhë i ka rreth një vit dhe tani nuk mund të as po as jo, por mund të them se gjendje faktike janë dokumentacionet.

**z.Rafet Llapashtica**, sërish i drejtohet drejtoir parafolës, theksoj, i nderuar drejtor, ju jeni me përvojë institucionale, ju rikujtoj se një investitorë nuk guxon të vijë tek ju të kërkoj leje ndërtimi apo plan ndërtimi, pa i poseduar dokumentet përkatëse që kërkohen.

**z.Durim Salihu**, drejtor i DI-së, theksoi, ajo çfarë ka ofruar operatori dëshmi nuk kanë qenë në harmoni me atë çfarë ai ka pretendua se duhet me qenë. Ai ka sjell një dokument të Ministrisë por, me atë dokument ai nuk mund t'i vazhdoj procedurat më tutje. I është kërkuar gojarisht se duhet t'i ketë NN dokumentet, por është luajt një lojë edhe prej nivelit qendrorë, një lloj lajthitje, unë mendoj ashtu, "hajt të jetë presioni në Komunë tani bëjmë një zgjidhje", e që në fakt Komuna është adresa e fundit për një gjë të tillë.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, në dokumentacion ka datë, dhe nëse investitori ka kërkuar tek ti si drejtor i Drejtorisë, sot një leje ndërtimi, kurse pëlqimet nga Ministria dhe të KEDS-it për kyçe në transmision i bënë pasnesër, ju paskeni bërë sjellje shumë butë ngase po të isha unë do ta largoja nga zyra menjëherë, mirëpo nëse operatori t'i ka sjell krejt dokumentet në dosje me të gjitha rregullat, edhe pse nuk e njoh atë person dhe në këtë rast më shumë jam në anën e juaj si drejtor, pra nëse ju ka përmbajt rregullave në aspektin ligjor dhe i ka kompletuara, përgjegjësi e Drejtorisë është t'ia ndal ose t'ia lëshoj lejen në mënyrë që pastaj të mos merr penallti gjyqësore.

**z.Durim Salihu**, drejtor, i DI-së, theksoi, ne kemi kërkuar miratim prej departamentit të mbrojtjes së ujërave, jo në atë formë qysh operatori ka thënë, por qysh kërkohet me ligj. Tani drejtori aktual i DPUMM z.Hamdi Jaha nuk është këtu prezent, është jashtë vendi dhe qasje në zyre nuk mund të kemi pa qenë ai, por do ta shikojmë tek zyrtarët tjerë rreth dokumentacioneve në mënyrë që të jemi sa më konkret në përgjigjet tona në Kuvend, mirëpo në atë kohë unë e ceka se ka situatë tepër e tensionuar, madje ka mund të vij edhe deri te ndonjë konflikt fizik, madje edhe grupe familjesh, andaj ajo ka qenë arsyeja që unë kam këmbëngul dhe kam thënë jo deri sa të zgjidhen problemet, kompletimi me dokumentacion etj.

**z.Fatmir Gashi**, kryesues, mendoj se është e mirë për neve si Kuvend dhe për juve si Ekzekutiv i Komunës që të jemi sa më të informuar rreth dokumentacionit dhe gjitha gjërave rreth këtij problemi në mënyrë që të marrim një qëndrim vërtetë sa më real dhe sa më të dobishëm që na takon neve si Kuvend dhe si përgjegjës të kësaj kërkesë të qytetarëve.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, siç jemi në dijeni para vetës kemi një peticion të qytetarëve dhe e kemi për obligim nesër në Kuvend ta shqyrtojmë. Konsideroj se nesër duhet të dalim me një qëndrim shëfat e Grupeve dhe të japim një përgjigje, dhe në këtë aspekt unë do të jem shumë i hapur me ju. Person në fjalë (investitori) sot ka qenë tek unë dhe ka sjell një zarf me dokumente dhe ka thënë që e ka dërguar tek të gjithë shëfat e Grupeve. Ai e ka një varg dokumentesh që i ka dërguar tek Drejtoria përkatëse. Fati është i mirë që Ekzekutivi është i ndamë prej Kuvendi dhe këta i dinë obligimet ligjore më së miri rreth kthimit të përgjigjeve. Nëse ne mbetemi në debat dhe koncentrohemi rreth vendimit a lejohet, a nuk lejohet do të mbesim edhe shumë orë këtu edhe nuk do të mund të zgjidhim asgjë. Është e vërtetë që investitori e ka një pëlqim në parim i cili specifikon qartë se ky pëlqim në parim nuk nënkupton posedimin e lejes ndërtimore për kërkesën në fjalë atë që tha edhe Drejtori z.Durim Salihu, por mua më intereson një çështje pak më shumë, fjala është tek pjesa e kërkesës së vazhdueshme të tij, dhe është fat që ne nuk e kemi obligim por e ka Ekzekutivi t'i shqyrtoj dhe kthej përgjigjet, gjithashtu investitori ka përcjell disa kërkesa prej Ministrive përkatëse njëra prej tyre është nga Zyra e Rregullatorit për Energji, shembull, i lëshohet autorizim preliminar shoqërisë "Monten" për zhvillimin e projektit, do të thotë që se nuk i jepet mundësi që

menjëherë të filloi të ndërtoj diçka, mirëpo nëse investitori të thirret vendime të tilla atëherë kjo na komplikon situatën edhe më shumë, ngase çdokush mund të mbush një varg dokumentesh në emër të një autorizimi preliminar, dhe pastaj të mundohet të filloj me zhvillimin e projektit, pra neve na qet në një tabor krejt tjetër duke u thirr në atë se, unë i kam të gjitha dokumentet dhe tani pres vetëm nga Komuna. Për këtë unë nuk mund të marrë përgjegjësi sepse nuk e njoh shumë këtë fushë, por nesër do të ishte mirë që Drejtori i Drejtorisë përkatëse të na informoj qartë për procedurën, kurse neve na mbetet t'ju kthejmë përgjigje qytetarëve. Nëse ne fillojmë të flasim për kompaninë ne po hyjmë në një fushë për të cilën nuk jemi të thirrur.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoj, rreth asaj që parafolësi e ceku, mendoj që ne si Kuvend të vetmen përgjigje që mund t'ju kthejmë atyre qytetarëve është lutja që të mos ndodh diçka, sepse ne as nuk japim lejen as nuk ndalim, as nuk kemi kompetencë me të ndalojmë, është çështje ligjore dhe kompetencë e Drejtorisë sa i përket lejeve urbanistike, përndryshe ne si Kuvend, pastaj Komuna si institucion, dhe shfat e Grupeve mund të debatojmë për problemin, dhe të mundohemi të gjejmë zgjidhje sa më të shpejt të këtij problemi. Në parim unë jam për investime dhe për punësim por gjithnjë në bazë të parametrave ligjor për mbrojtje të ambientit. Nëse kemi të bëjmë me pronë private mendoj se nuk kemi kompetencë për një gjë të tillë.

**z.Durim Salihu**, drejtor i DI-së, theksoi, nuk kemi të bëjmë me pronë private ngase do të bëhej fjalë për leje ndërtimi për objekt, mirëpo kemi të bëjmë me rrjedh të shtrirjes së distribuimit si dhe jemi në dijeni se uji nuk është pronë private, por i njëjti gjeografikisht i takon territorit të Komunës së Podujevës.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sa i përket hidrocentraleve, unë kam vizituar “Valbonën” dhe e di që ajo është zonë e mbrojtje nacionale për të cilën u përfol shumë nga qytetarë dhe opinione të ndryshme se po degradohet ai vend e që mendoj se është u degraduar ata lumenj sepse ne nuk kemi përvoja në këtë fushë andaj edhe bash më ka ngjall interesim një gjë e tillë, sikurse që ka Shqipëria.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, në bazë të asaj çka qytetarët kanë paraqitur tek ne përmes peticionit, ne duhet të mbrojmë interesin e qytetarëve. Nuk mund të krahasojmë ujin e “Valbonës” sa është kapaciteti atje edhe ujin tek ne në Kosovë ku gjatë verës edhe kemi raste ku shtjerrën pothuajse në tërësi.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sa jam në dijeni unë ujë nuk humb por hyn nëpër gypa, prodhohet rryma dhe del në rrjedhë tjetër.

**z.Fatmir Gashi**, kryesues, po vërej që diskutimet përfunduan rreth kësaj teme, andaj sa vërejtja të gjithë ishin që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe debat.

*Njëzëri u pajtuan që materiali sipas kësaj pike të rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe diskutim të mëtejshëm.*

**Mbledhja përfundoi në orën 14:15**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0078485/18**  
**Podujevë,**  
**25 shtator 2018**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Fatmir Gashi**